



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:261522

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05705183

C.nr.1281/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, nga Gjyqtari Robert Tunaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorës profesionale Mirvedete Bekteshi në çështjen juridike civile të paditësve; Q.TH,Q, B.N, A.L, T.Z, L.C, G.K, H.B, SH.B, Z.L, H.B, F.B, M.K, E.Z, S.K, B.B, N.K, S.B, S.K, S.L.J B.A, F.R, H.K, L.K, M.K, A.B.M, P.S, R.S.K, B.S, dhe B.H, B, S.K, B.B, N.K, S.B, S.K, S.L.J B.A, F.R, H.K, L.K, M.K, A.B.M, P.S, R.S.K, B.S, dhe B.H, mësimdhënës në SHFMU “Dëshmorët e Greikocit” në G, të cilët me autorizim i përfaqëson Av.B. C, av. nga P. Rr” Rifat Burdzeviq, ndaj të paditurës K e S, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor i K së S, A. B, sipas padisë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, me dt.20.05.2024 bie këtë:

A K T G J Y K I M **Pa shqyrtim kryesor**

I.APROVOHET në tërësi e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve Q.TH,Q, B.N, A.L, T.Z, L.C, G.K, H.B, SH.B, Z.L, H.B, F.B, M.K, E.Z, S.K, B.B, N.K, S.B, S.K, S.L.J B.A, F.R, H.K, L.K, M.K, A.B.M, P.S, R.S.K, B.S, dhe B.H, Baraliu, S.K, B.B, N.K, S.B, S.K, S.L.J B.A, F.R, H.K, L.K, M.K, A.B.M, P.S, R.S.K, B.S, dhe B.H, mësimdhënës në SHFMU “Dëshmorët e Greikocit” në G.

II.DETYROHET e paditura K e S – D. K e A, që paditësve në emër të kompensimit të shujtave ditore t’ia paguaj shumat si në vijim

1.Qëndresa Th – Q, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro**,

2.B. N, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - 30.12.2021 dhe 01.01.2022 deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

3.A. L, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 01.09.2021 - deri me 15.07.2022 për 216 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **432 Euro,**

4.T. Z, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

5. L. C, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 01.09.2021 deri me 15.07.2022 për 216 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **432 Euro,**

6.G. K, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

7.H. B, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

8.Sh. B, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

9.Z. L, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 146 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **292 Euro,**

10.H. B, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 01.09.2021 - deri me 15.07.2022 për 216 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **432 Euro,**

11.F. B, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

12.M. B, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

13.E. Z, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

14.S. K. A, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 deri me 15.07.2022 për 216 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **432 Euro,**

15.B. B, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 15.07.2022 për 216 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **432 Euro,**

16. B. A, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 152 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **304 Euro,**

17. F. R, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

18. H. K, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 152 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **304 Euro,**

19. L. K, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

20. M. K, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

21. N. K, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 152 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **304 Euro,**

22. S. B, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

23. S. K, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

24. S. L. J, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

25. A. B, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

26. P. S, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

27.R. S. K, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

28. B. S, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,**

29. B. H, në emër të kompensimit të shujtave ditore për periudhën 27.09.2021 - deri me 24.06.2022 për 183 ditë pune x 2 euro, në shumën totale prej **366 Euro,** t'ia paguaj me kamatë ligjore 8 % nga data e parashtrimit të padisë 09.12.2022 e deri te pagesa definitive

III.OBLIGOHET e paditura që paditësit t'ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës dhe atë : për përpilimin e padisë 325 euro, për precizimin e padisë 325 Euro si dhe taksën gjyqësore në shumën 21 euro, në total shumën 671 euro sipas TOAK-së, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit Q.TH,Q, B.N, A.L, T.Z, L.C, G.K, H.B, SH.B, Z.L, H.B, F.B, M.K, E.Z, S.K, B.B, N.K, S.B, S.K, S.L.J B.A, F.R, H.K, L.K, M.K, A.B.M, P.S, R.S.K, B.S, dhe B.H, Baraliu, S.K, B.B, N.K, S.B, S.K, S.L.J B.A, F.R, H.K, L.K, M.K, A.B.M, P.S, R.S.K, B.S, dhe B.H, mësimdhënës në SHFMU “Dëshmorët e Greikocit” në G, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. B. C nga P, pranë kësaj Gjykate me datën 09.12.2022 kan parashtruar padi, kundër të paditurës K e S – D. K e A, për pagesën e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe Ligji i Punës nr.03/L-212. Me datën 04.03.2024 avokati B. C, është tërhequr nga kërkespadia për paditësin Haki Haziraj sipas lëndës C.nr.1281/2022.

E paditura përmes përgjigjes në padi të dt.27.10.2023 e kundershtron padinë dhe kërkespadinë e paditësve për shkak se të njejtit pagesen e tyre

e kan realizuar nga Thesari i shtetit, si dhe paditesit në padin e tyre nuk kan paraqit asnjë prove – vertetim te leshuar nga shkolla për ditet e vijueshmerise në pune, ndaj ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkangjitura padisë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjithat së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve është **e bazuar**.

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.*

Ndërsa në nenin 152 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Nga analizimi i përgjigjes në padi, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit për periudhën e ditëve të punës të cilën e kërkojnë me padi nuk janë paguar nga Thesari i Shtetit me ç ‘rast gjykatës i kanë sjell prova të besueshme nga Institucioni publik, dhe për gjykatën është sajuar e drejta që në këtë çështje juridiko civile vendimmarrja të bëhet pa shqyrtim kryesor, me të vetëm arsye për zbatimin e ekonomizimit të procedurës, parim ky i sanksionuar dhe i urdhëruar për gjykatën për t’u zbatuar konform nenit 10 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore, siç parasheh: *“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”*

Në nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i*

mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”

I autorizuari i paditësve me rastin e ngritjes së padisë, për kompensimin e shujtave, i ka bashkëngjitur padisë vërtetimet lidhur me provimin e fakteve për ditët e vijueshmërisë në punë, të cilat paraqiten si bazë për kërkimin e shumave të paguara.

Nga shikimi në vërtetimeve të cilat i ka prezantuar i autorizuari i paditësve, me rastin e ngritjes së padisë, për kompensimin e shujtave padisë i ka bashkëngjitur: autorizimet për përfaqsim, kontratat e punës, listën e pagave, vërtetimet nga mardhënja e punës të lëshuara nga SHFMU “Dëshmorët e Greikocit” në G.

Bazuar në provat e lartcekur, shihet se kërkesa e paditësit gjen mbështetje të plotë në nenin 35 pika 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, ndërmjet SBASHKU-ut dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, siç parasheh: *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare të institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim.*

Gjykata vendosi që t’ia falte besimin provave që ka prezantuar paditësi, konkretisht vërtetimeve të lëshuara SHFMU “Dëshmorët e Greikocit” në Greikoc - Suharekë, pasi të njëjtat janë nxjerr nga një organ që është i pajisur me autorizime publike, çka për gjykatën kjo provë ka fuqi të saktësisë për atë që konfirmon, bazuar në nenin 329 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore.

Vendimi mbi aprovimin e kërkespadisë, është mbështetur në nenin 35 pika 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së.

Gjykata Aktgjykimin e muarr në kuptim të nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË,
C.nr.1281/2022 dt.20.05.2024**

**Bashk.profesionale
Mirvedete Bekteshi**

**Gjyqtari
Robert Tunaj**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.